



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Zgjedhjet e Lokale

22 Tetor 2017

Lista Përfundimtare e Votuesve

2017

PËRMBAJTJA

QËLLIMI.....	3
PËRMBLEDHJE.....	3
PËRSHKRIM.....	4
PERIUDHA E SHËRBIMIT TË VOTUESVE.....	5
PRANIMI I SHKRESËS NGA KËSHILLIT GJYQËSORË.....	6
PERIUDHA E KUNDËRSHTIMIT DHE KONFIRMIMIT.....	6
VOTIMI JASHTË KOSOVËS.....	7
KRIJIMI I LISTËS PËRFUNDIMTARE TË VOTUESVE.....	8
REKOMANDIMET PËR AGJENCINË E REGJISTRIMIT CIVIL.....	8
PËRMBLEDHJE TABELORE	
(Numri i votuesve, numri i QV, numri i VV dhe numri i votuesve për qendra të votimit).....	9
SHTOJCA 1: Shembull se si duken faqet e Listës Përfundimtare të Votuesve për vendvotimin e rregullt.	
SHTOJCA 2: Shembull se si duken faqet e Listës Përfundimtare të Votuesve për vendvotimin e dyfishtë.	
SHTOJCA 3: Shembull se si duken faqet e Listës së Votuesve me kusht.	

Qëllimi

Në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është e obliguar që të certifikoj listën e votuesve në raport me zgjedhjet e caktuara¹. Ky dokument e mbështetë procesin e certifikimit të listës së votuesve për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen me datën 22 tetor 2017.

Përmbledhje

Lista Përfundimtare e Votuesve (**LPV 2017**) për Zgjedhjet Lokale bazohet në Ekstraktin e Regjistrimit Qendror Civil². Ky ekstrakt është përpiluar nga Agjencia e Regjistrimit Civil, gjegjësisht Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve (DPA), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

- I. Lista Përfundimtare e Votuesve 2017 për Zgjedhjet e Lokale përmban:
 - **1,890, 952** emra të votuesve, me dallim prej **18,011** votues më shumë, në krahasim me Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 11 qershor 2017.
- II. Numri i Qendrave të Votimit (QV) është **tetëqind e nëntë dhjetë e nëntë (899)**. **Dhjetë (10)** qendra të votimit më shumë se në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 11 qershor 2017, dhe
- III. Numri i vendvotimeve është **dymijë e pesëqind e pesë (2505)**. **Pesëmbëdhjetë (15)** vendvotime më shumë se në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 11 qershor 2017.

¹ Ligji Nr. 03/L-256, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Neni 64.2, pika (g).

² Ibid, Neni 7.1, pika (a) dhe (b).

Përshkrimi

Pas pranimit të ekstraktit nga Regjistri Qendror Civil³, Divizioni i Shërbimit të Votuesve, ka bërë caktimin e votuesve në qendra të votimit.

Numri i votuesve të rinj që do të votojnë për herë të parë në Zgjedhjet Lokale më 22 tetor 2017 është: **18,011 votues**.

- a) **14,176 votues** të rinj që pas Zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2017 kanë arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe që do të votojnë për herë të parë në Zgjedhjet Lokale më 22 tetor 2017⁴.
- b) **3,835 votues** që nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve në Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 2017, e që mund të konsiderohen si votues të regjistruar për herë të parë në Regjistrin Qendror Civil midis dy palë zgjedhjesh ose votues që janë pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës pas zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2017.
- c) Numri i emrave të personave që janë larguar si të vdekur pas Zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2017 dhe numri i votuesve që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës është: **4,656**.
- d) Numri i votuesve që kanë ndërruar adresa në mes dy palë zgjedhje nga një komunë në tjera: **5,252 votues**.
- e) **9,624** votues janë caktuar në qendrat e reja të votimit, dhe
- f) **8,822** votues që kanë votuar me kusht në Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2017, janë caktuar të votojnë në qendrat e votimit që kanë votuar me kusht.

³ Rregulla Zgjedhore Nr. 2/2013, Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, Neni 3.2 dhe 3.3.

⁴ Votuesit, të cilët kanë mbushur moshën 18 vjeç pas datës 11 qershor 2017 (pas datës së Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës) dhe që do t'i mbushin 18 vjeç me datën 22 tetor 2017.

Periudha e shërbimit të votuesve

Periudha e Shërbimit të Votuesve ka filluar me datën 26 korrik 2017 dhe ka përfunduar me datën 12 shtator 2017⁵.

Gjatë kësaj kohe, të gjithë votuesit kanë pasur mundësi të informohen se në cilën qendër të votimit janë caktuar të votojnë ose të kërkojnë ri-caktim të qendrës së votimit më të përshtatshme për ta.

Gjatë kësaj periudhe, makina kërkuese është shfletuar **139,867** herë.

Numri i kërkesave për ndërrimin e qendrave të votimit është: **8,218**.

1. **4,741** kërkesa për ndërrim të qendrave të votimit janë parashtruar në zyrat e komisioneve komunale zgjedhor⁶.
2. **3,477** kërkesa për aplikim janë parashtruar përmes aplikacionit online për ndërrimin e qendrave të votimit që ka qenë e vendosur në ueb faqen e KQZ-së gjatë periudhës për ndërrimin e qendrave të votimit.
 - a) **7,409 kërkesa** janë aprovuar,
 - b) **809 kërkesa** janë refuzuar, për këto arsye:
 - për shkak që votuesit kanë kërkuar ndërrim të qendrave të votimit në qendrat e votimit split, ku ndarja e votuesve bëhet në bazë të shkronjave të para të mbiemrit,
 - për shkak që nuk kanë dëshmuar identitetin,
 - për shkak që votuesi kanë kërkuar ndërrim të qendrave të votimit nga një komunë në komunën tjetër,
 - për shkak që votuesit kanë aplikuar për ndërrim të qendrave të votimit më shumë se një herë.

⁵ Rregulla Zgjedhore Nr. 17/2013 Periudha e Shërbimit të Votuesve për Ndërrimin e Qendrës së Votimit, Neni 4.2.

⁶ Kërkesat përmes formularëve të aplikimit janë parashtruar në tridhjetë e një (31) komuna të Republikës së Kosovës.

Pas kësaj periudhe, Divizioni i Shërbim të Votuesve ka vendosur të gjitha ndryshimet në listën e votuesve, e cila më pas është integruar në ekstraktin e fundit që është pranuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil/ Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve.

Pranimi i Shkresës nga Këshilli Gjyqësorë i Republikës së Kosovës

Bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr. 02/ 2013, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, para fillimit të Periudhës së Konfirmimit dhe Kundërshtimit të Listës së Votuesve, me kërkesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës ka pranuar listën me **319** emra të personave që u është marrë zotësia e veprimit me vendim gjyqësorë nga gjykatat themelore dhe degët e tyre nëpër komuna⁷.

Nga analizimi i këtyre të dhënave me emër, mbiemër, datë të lindjes dhe numër personal të letërnjoftimit, janë larguar **150 persona**.

Ndërsa, për **169** persona nuk është mundur të bëhet identifikimi i tyre në listën e votuesve, për shkak se listat që janë pranuar nga Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës përmbajnë vetëm emrin dhe mbiemrin.

Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit

Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit të Listës së Votuesve ka filluar me datën 29 gusht 2017 dhe ka përfunduar me datën 12 shtator 2017⁸ Gjatë kësaj periudhe, votuesit kanë pasur mundësi që ta sfidojnë Listën preliminare të votuesve në gjykatat e shkallës së parë.

Sekretariati i KQZ-së, para fillimit të Periudhës së Konfirmimit dhe Kundërshtimit të Listës së Votuesve, i ka njoftuar personat kontaktues të subjekteve politike të certifikuar për zgjedhjet, për tu pajisur me CD-të që kanë përmbajtur Listën Preliminare të Votuesve⁹.

Gjatë kësaj periudhe, **asnjë votues** nuk ka konfirmuar dhe kundërshtuar të dhënat në Listën e Votuesve.

⁷ Rregulla Zgjedhore Nr. 02/2013 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimit i Listës së Votuesve, Neni 3.5 dhe neni 3.6.

⁸ Rregulla Zgjedhore Nr.2/2013 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, Neni 3.8.

⁹ Rregulla Zgjedhore Nr.2/2013 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, Neni 5.1.

Votimi jashtë Kosovës

Programi i Votimit jashtë Kosovës, Periudha e Aplikimit për Regjistrimit është ndërmarrë prej datës 16 korrik 2017 deri me datën 23 gusht 2017¹⁰. Divizioni i Shërbimit të Votuesve ka dërguar 15,118 aplikacione për regjistrim, votuesve që në Zgjedhjet e për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2017 kishin arritur të dëshmonin kriteret e zotësisë juridike për të votuar. Informatat e nevojshme dhe formularët për regjistrim janë publikuar në ueb faqen zyrtare të KQZ-së.

Përgjatë periudhës së aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, përmes adresës postare të KQZ-së, Faksit dhe adresave elektronike, kemi pranuar **11,813** aplikacione për regjistrim.

- a) Të regjistruar si votues të suksesshëm: **10,476**,
- b) Të refuzuar: **1,337** aplikacione për regjistrim:
 - **1** aplikues i refuzuar nën moshën 18 vjeçare,
 - **420** aplikues që kanë aplikuar me dokumente valide të identifikimit, por që nuk kanë dërguar dokumente me të cilat do të vërtetohej njëra nga kriteret zotësisë juridike për tu përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës,
 - **339** aplikues janë refuzuar për shkak që kanë dërguar dokumente të identifikimit me afat të skaduar (jo valide),
 - **457** aplikues janë refuzuar për shkak që kanë dërguar vetëm formularin e aplikimit për regjistrim,
 - **18** aplikues janë refuzuar për shkak që nuk kanë nënshkruar formularin e aplikimit,
 - **51** aplikues janë refuzuar për arsye kanë dërguar aplikacione prej së paku dy shteteve të ndryshme, herën e parë përmes e-mailit dhe herën e dytë përmes postës, ku nënshkrimet në aplikacione janë të ndryshme. Numri i aplikacione të refuzuar për këtë kategori është 102 aplikacione.

¹⁰Rregulla Zgjedhore Nr. 03/2013 Votimi jashtë Kosovës, Neni 3.5..

Bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr. 03/ 2013 Votimi jashtë Kosovës, votuesit që kanë aplikuar suksesshëm dhe që janë shtetas të Republikës së Kosovës, janë larguar nga lista e votuesve brenda vendit që përdoret në vendvotime¹¹.

Numri i votuesve që janë larguar nga Lista Përfundimtare e Votuesve që përdoret nëpër vendvotime është: **9,956 votues**.

Krijimi i LPV-së

Pas përfundimit të Periudhës së Shërbimit të Votuesve dhe Periudhës së Konfirmimit dhe Kundërshtimit të LV-së, Divizioni për Shërbim të Votuesve i ka caktuar votuesit nëpër vendvotime sipas renditjes alfabetike. Të dhënat e reja janë shtypur në format PDF dhe kualiteti është kontrolluar nga ana e Divizionit të Shërbim të Votuesve. Këto dokumente janë të gatshme për t'ju dërguar kompanisë e cila do ta bëjë shtypjen e Listës Përfundimtare të Votuesve 2017.

Rekomandimet për Agjencinë e Regjistrimit Civil/ Regjistrin Qendror Civil

Divizioni i Shërbimit të Votuesve vlerëson bashkëpunimin e ngushtë dhe profesional me Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Lidhur me proceset e ardhshme të krijimit të Listës së votuesve, Divizioni i Shërbimit të Votuesve ofron këto rekomandime:

- Gjatë krijimit të listës së votuesve, mos përfshirja korrekte e adresave për votuesit, po vazhdon të shkaktoj probleme në caktimin e saktë të votuesve nëpër qendra të votimit. Për zgjedhjet e ardhshme duhet të bëhen përpjeke që bashkëpunimi në mes KQZ-së dhe MPB-së në këtë aspekt të intensivkohet, në mënyrë që adresat unike të përfshihen në të dhënat e qytetarëve në Regjistrin Qendror Civil.

¹¹ Rregulla Zgjedhore Nr. 03/ 2013 Votimi jashtë Kosovës, Neni3.8.

Përmbledhje tabelore

1. Numri i votuesve, Numri i Qendrave të Votimit dhe Numri i Vendvotimeve për komunat e Republikës së Kosovës.

Nr.	Komunat	Numri i Votuesve	Numri i Qendrave të Votimit	Numri i Vendvotimeve
01	Deçan	42447	14	54
02	Gjakovë	114418	34	144
03	Glllogoc	53408	29	72
04	Gjilan	100399	34	129
05	Dragash	40338	34	59
06	Istog	47683	23	63
07	Kaçanik	33917	21	47
08	Klinë	47408	20	62
09	Fushë Kosovë	36361	15	45
10	Kamenicë	38013	28	56
11	Mitrovicë e Jugut	79042	28	100
12	Leposaviq	17747	18	31
13	Lipjan	59548	34	82
14	Novobërdë	9848	19	22
15	Obiliq	24582	17	35
16	Rahovec	57200	35	78
17	Pejë	110691	24	132
18	Podujevë	84088	45	111
19	Prishtinë	188341	58	236
20	Prizren	168884	71	219
21	Skenderaj	54970	35	76
22	Shtime	26356	17	36
23	Shtërpcë	13781	9	21
24	Suharekë	66390	33	88
25	Ferizaj	108561	44	139
26	Viti	49317	31	66
27	Vushtrri	71978	32	95
28	Zubin Potok	8400	12	15
29	Zveçan	9069	7	13
30	Malishevë	52273	35	73
31	Junik	5590	1	7
32	Mamushë	3935	1	5
33	Hani i Elezit	8995	4	11
34	Graçanicë	21163	15	32
35	Ranillug	5578	7	10
36	Partesh	4694	3	7

37	Klokot	3742	5	7
38	Mitrovicë e Veriut	21797	7	27
		1,890,952	899	2,505